

# SI MUND TA MBAJ FËMIJËN TIM LARG RREZIQEVE NË INTERNET?

Vendosni që në fillim disa rregulla për përdorim të kompjuterit, telefonit celular dhe internetit dhe, sigurohuni për respektimin e këtyre rregullave nga ana e fëmijës tuaj.

Ju mund të instaloni programe të ndryshme të cilat mund të:

- Blllokojnë ueb faqe të papërshtatshme;
- Blllokojnë viruse dhe "spame" në kompjuter;
- Monitorojnë çdo ueb faqe që fëmija juaj viziton;
- Kufizojnë kohën e qëndrimit online të fëmijës.



## JO INTERNET NË DHOMË TË FËMIJËVE!

*Të gjitha pajisjet që lidhen me internet, si: kompjuter, laptop, telefon, iPad, etj., duhet të jenë në hapësirë të përbashkët të shtëpisë, aty ku ju mund të shihni se çfarë bën fëmija juaj.*



## KËSHILLA TË PËRGJITHSHME:

Rregullisht kontrolloni historinë në "internet browser" në mënyrë që të dini se çfarë bën fëmija juaj online.

Interesimi juaj për të ditur se çfarë po bën fëmija juaj në internet, me kënd po bisedon, çfarë faqe po viziton, nuk është shkelje e privatësisë së fëmijës. Ju vetëm po

e monitoroni atë në hapësirën digjitale, ashtu si e monitoroni në jetën e përditshme.

Shmangeni blerjen e telefonit mobil të mençur (me internet dhe kamerë) për fëmijët tuaj sepse mund të bëhen keqpërdorime të ndryshme.

### Qendra për studime të avancuara FIT

Adresa: Rruga Eqrem Çabej, nr 166,  
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

E-mail: [info@fit-ks.org](mailto:info@fit-ks.org)  
[www.fit-ks.org](http://www.fit-ks.org)  
[www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)

### Save the Children

Gazmend Zajmi nr.1, 10000 Prishtine Kosove  
Phone: +381 (0) 38 55 26 91  
Fax: +381 (0) 55 26 90  
[scik@savethechildren.org](mailto:scik@savethechildren.org)  
[www.savethechildren.net](http://www.savethechildren.net)  
[www.kosovo.savethechildren.net](http://www.kosovo.savethechildren.net)  
[www.facebook.com/savethechildreninkosova](https://www.facebook.com/savethechildreninkosova)

Shokët/shoqet e fëmijës tuaj mund ta kenë të lejuar përdorimin e internetit kudo. Ju mund të bisedoni me prindërit e tyre dhe t'i njoftoni për mënyrat se si mund të përdorin programe të ndryshme rreth bllokimit të ueb faqeve të papërshtatshme.

Interesohuni më shumë rreth përdorimit të internetit dhe jeni në hap me kohën rreth tij.



## SIGURIA NË INTERNET SA ËSHTË I SIGURT FËMIJA IM NË INTERNET?



# ÇFARË BËNË FËMIJA IM NË INTERNET?

Jemi dëshmitarë që sot fëmijët janë shumë aktivë në përdorimin e internetit.



## FËMIJËT E PËRDORIN INTERNETIN PËR TË:

LUAJTUR LOJËRA TË NDRYSHME;

KOMUNIKUAR ME NJERËZ;

HULUMTUAR PËR GJËRA TË NDRYSHME;

SHPËRNDARË INFORMACIONE, ETJ.


Të gjeturat nga hulumtimi i bërë në Mars 2014 nga Qendra për studime të avancuara FIT në partneritet me organizatën Save the Children tregojnë se:

- 93% e fëmijëve janë përdorues të internetit, ndërsa 63% e tyre e përdorin internetin çdo ditë ose gati çdo ditë;
- 84% e fëmijëve kanë llogari të veten aktive në Facebook ose Twitter, prej të cilëve 32% kanë mbi 400 miq;
- 42% e fëmijëve kanë deklaruar që kanë parë përmbajtje pornografike në internet dhe janë shqetësuar nga ato pamje, ndërsa 61% kanë deklaruar që kanë parë foto ose video më përmbajtje luftarake dhe agresive;
- 58% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë kontaktuar përmes internetit me persona të panjohur, 69% e këtyre fëmijëve janë takuar edhe personalisht me persona të panjohur.



# SI TË KOMUNIKOJ ME FËMIJËN TIM RRETH INTERNETIT?

Lejoni fëmijën tuaj të ju mësojë për veprimet e tij në internet, ngaqë askush më mirë se ai nuk është në dijeni se çfarë bën ai online. Pastaj pyesni fëmijën:



# ME ÇFARË RREZIQË MUND TË PËRBALLET FËMIJA IM NË INTERNET?

Rreziqet më të shpeshta me të cilat përballen fëmijët gjatë përdorimit të internetit janë:

Sajbërdhuna është përdorimi i pajisjeve elektronike për të ngacmuar, frikësuar, turpëruar, dhe kërcënuar të tjerët nëpërmjet mesazheve, fotografive, dhe postimeve tjera në internet.

- ueb faqet me përmbajtje të papërshtatshme;
- sajbërdhuna;
- vjedhja e informatave personale;
- takimi me njerëz të panjohur;
- varësia ndaj internetit;
- viruset dhe "spamet" e ndryshme.

## KËSHILLA:

- Bisedoni më shumë me fëmijën rreth sajbërdhunës;
- Kujdes me "dhomat e çatit/bisedës" për fëmijën tuaj, (interneti nuk është vend i përshtatshëm për të bërë shoqëri të re);
- Mësoni fëmijën tuaj të krijoj fjalëkalime që nuk mund të zbulohen lehtë;
- Mësoni fëmijës tuaj dallimin në mes të informatave personale dhe informatave publike;
- Cakttoni kohën se sa mund të qëndroj në internet.

